

VENDIM
Nr.381, datë 31.5.2005

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.424, DATË 9.7.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE QË
KRIJOJNË INSTITUCIONET BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shkronjën “b” të pikës 1 të vendimit nr.424, datë 9.7.1998 të Këshillit të Ministrave të shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Të ardhurat me pjesëmarrje, të realizuara nga Agjencia Telegrafike Shqiptare, nga shitja e lajmeve me kompjuter+modem, si dhe nga shërbimi fotografik, t’i mbeten këtij institucioni, në masën 90 për qind, ndërsa 10 për qind të derdhen në Buxhetin e Shtetit.”.

2. Ngarkohen Ministri i Financave dhe Agjencia Telegrafike Shqiptare për nxjerrjen e udhëzimit të përbashkët, për përdorimin e këtyre të ardhurave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano